



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 169, Datë 07.11.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KROI MBRET ENERGJI”
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10 pika 1, 3 dhe 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr.101/1 Prot., datë 31.10.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Konstatohet se:

- Shoqëria “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 634 Prot, datë 11.10.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Kjo shoqëri është regjistruar në datën 20.07.2012 pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), konform Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, dhe mban numër identifikimi (NUIS) L29326401S. Shoqëria “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k., përfaqësohet nga administratorja znj. Flutura Ismaili dhe kapitali zotërohet nga ortaku i vetëm: “Alba Konstruksion” sh.p.k.
- Objekti i veprimtarisë së saj është: “Ndërtim-Operim dhe transferimi i hidrocentraleve: “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B”, “Backa C”, tek Autoriteti Kontraktues ku përfshihen finacimi, ndërtim, vënia në punë, prodhim, furnizimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike në zbatim të Kontratës Kocensionare nr.1616 Rep, Nr. 374 Kol, datë 26.06.2012”.
- Aplikimi i shoqërisë “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht;
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8; gërmat “a”, “b”, “c”, “d”,) është plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2: gërma “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë, lista e personelit sipas profilit (në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3: gërma “b” (bilanci financiar për vitet 2016 dhe 2017).
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Neni 9, pika 4.8: gërma “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tregtuar në GWh / sipas viteve); gërma “b” (Evidentimi i të ardhurave që do të përdorën për qëllime të veprimtarisë së licencuar)

do të njoftohet aplikuesi që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “KROI MBRET ENERGI” sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI